

VENDIM
Nr. 286, datë 19.5.2021

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 555, DATË 11.8.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË PERSONELIT MJEKËSOR, TË PUNONJËSVE ME ARSIM TË LARTË DHE TË PUNONJËSVE TË PERSONELIT TEKNIK TË SHKENCAVE MJEKËSORE, NË SISTEMIN E MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR SHËNDETËSINË, NË NJËSINË MJEKËSORE USHTARAKE PRANË SPITALIT UNIVERSITAR TË TRAUMËS, NË STRUKTURAT E TJERA TË FORCAVE TË ARMATOSURA DHE NË INSTITUCIONET E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE DHE SPITALIN PËRKATËS", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa e ndryshime:

a) Në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 2, pas fjalëve "... në strukturat shëndetësore universitare ..." shtohen fjalët "... në spitalet e nivelit terciar ...".

b) Lidhja 1/AP, që përmendet në shkronjën "a", të pikës 2, dhe kreu 1/1, që përmendet në shkronjën "b", të pikës 2, zëvendësohen përkatësisht me lidhjen 1/AP "Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e administrimit të përgjithshëm nga "specialist" deri në "titullar institucioni" në struktura shëndetësore universitare, në spitalet e nivelit terciar, në spitalet rajonale, spitalet psikiatrike dhe spitalet bashkiake" dhe kreun 1/1 "Struktura dhe nivelet e pagave për personelin mjekësor në strukturat shëndetësore universitare, në spitalet e nivelit terciar dhe në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës", që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

c) Kreu 2.1, i lidhjes nr. 2, që përmendet në pikën 2, zëvendësohet me kreun me të njëjtin numër dhe me titull "Struktura dhe nivelet e pagave për personelin teknik të shkencave mjekësore në strukturat shëndetësore universitare e në spitalet e nivelit terciar dhe personelin teknik të shkencave mjekësore, civilë, në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës", që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

ç) Në pikën 13, pas fjalëve "... kërkimore-shkencore ..." shtohen fjalët "... si dhe në spitalin rajonal "Memorial" Fier ...".

d) Pas pikës 19 shtohet pika 20, me këtë përmbajtje:

"20. Për një periudhë tranzitore (3-vjeçare) të funksionimit të spitalit rajonal "Memorial" në Fier, në bashkëpunim me personat e caktuar nga Ministria e Shëndetësisë Turke, pagat e punonjësve turq, të personelit të administrimit të përgjithshëm, të personelit mjekësor dhe të personelit teknik të shkencave mjekësore, të jenë të njëjta me pagat e çdo pozicioni respektiv pune, sipas lidhjes nr. 1/AP, lidhjes nr. 1 (kreu 1.1) dhe lidhjes nr. 2 (kreu 2.1) të këtij vendimi.

Përveç pagës, sipas lidhjeve përkatëse si më sipër, punonjësit turq të personelit të administrimit të përgjithshëm, të personelit mjekësor dhe të personelit teknik të shkencave mjekësore do të përfitojnë edhe një shpërblim mujor, në masën e përcaktuar në lidhjen nr. 10, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij."

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2021, për spitalin rajonal "Memorial" në Fier, përballohen nga fondet e miratuara për Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe nga buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe fillojnë nga data e emërimit të punonjësve në detyrë.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lidhja nr. 1 (lidhja 1/ap)

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e administrimit të përgjithshëm nga “specialist” deri në “titullar institucioni” në struktura shëndetësore universitare, në spitalet e nivelit terciar, në spitalet rajonale, spitalet psikiatrike dhe spitalet bashkiake

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Titullar institucioni në QSU “Nënë Tereza” Titullar institucioni në spitalin rajonal “Memorial” Fier	1	2%	0	118.600	25.000
2	Titullar institucioni në: - Spitalin Universitar të Sëmundjeve të Mushkërive “Shefqet Ndroqi” Tiranë - Spitalin Universitar Obsetrik Gjinekologjik nr. 1 dhe nr. 2 Tiranë - Spitalin Universitar të Traumës Tiranë	1	2%	0	118.600	15.000
3	Titullar institucioni në: - Klinikën Stomatologjike Universitare Tiranë - Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut - Zëvendëstitullar institucioni në QSU “Nënë Tereza” - Zëvendëstitullar institucioni në spitalin rajonal “Memorial” Fier	1	2%	0	110.000	15.000
4	Titullar institucioni në spitalet rajonale Titullar institucioni në spitalet psikiatrike Zëvendëstitullar institucioni në: - Spitalin Universitar të Sëmundjeve të Mushkërive “Shefqet Ndroqi” Tiranë - Spitalin Universitar Obsetrik Gjinekologjik nr. 1, nr. 2 Tiranë - Klinikën Stomatologjike Universitare Tiranë - Spitalin Universitar të Traumës Tiranë - Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut	1	2%	0	97.000	
5	Titullar institucioni në spitalet bashkiake	1	2%	0	95.000	
6	Zëvendëstitullar institucioni në spitalet rajonale/psikiatrike/bashkiake	1	2%	0	82.000	
7	Drejtor drejtorie në QSU “Nënë Tereza” Drejtor drejtorie në spitalin rajonal “Memorial” Fier	1	2%	0	82.000	
8	Përgjegjës sektori biomedikal	1	2%	0	74.000	
9	Administrator për polin e administrimit të integruar në QSU “Nënë Tereza”	1	2%	0	65.000	
10	Përgjegjës sektori në sektorët e përmbytjes në spitalet universitare dhe në QKTGJ Përgjegjës sektori në sektorët e përmbytjes në spitalin rajonal “Memorial” Fier	1	2%	0	61.000	

11	Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës në spitalet universitare Përgjegjës sektori Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut Përgjegjës sektori në Klinikën Stomatologjike Universitare Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës në spitalin rajonal “Memorial” Fier	1	2%	0	59.000	
12	Përgjegjës sektori në spitalet rajonale dhe psikiatrike	1	2%	0	49.000	
13	Specialist/inxhinier biomedikal në spitalet universitare, në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut dhe në spitalin rajonal “Memorial” Fier	1	2%	0	61.000	
14	Përgjegjës sektori në spitalet bashkiake Specialist/inxhinier biomedikal në spitalet rajonale, psikiatrike dhe bashkiake	1	2%	0	49.000	
15	Specialist auditi/Specialist në QSU “Nënë Tereza” dhe në spitalin rajonal “Memorial” Fier	1 ose 2, ose 3	2%	0	43.000	
16	Specialist auditi/Specialist në: - Spitalet universitare - Klinikën Stomatologjike Universitare Tiranë - Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut	1 ose 2, ose 3	2%	0	40.000	
17	Specialist auditi/specialist në spitalet rajonale dhe psikiatrike	1 ose 2, ose 3	2%	0	38.000	
18	Specialist në spitalet bashkiake	1 ose 2, ose 3	2%	0	34.200	

Lidhja nr. 1 (kreu 1.1)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin mjekësor në strukturat shëndetësore universitare, në spitalet e nivelit terciar dhe në njësinë mjekësore ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Shef Shërbimi infektiv në QSUNT Shef Shërbimi infektiv në spitalin rajonal “Memorial” Fier	1	2%	0	103.600	8000
2	Shef shërbimi	1	2%	0	103.600	
3	Shef reparti infektiv në QSUNT Shef reparti infektiv në spitalin rajonal “Memorial” Fier	1	2%	0	90.300	8000
4	Shef reparti/klinike (kirurgji, urgjencë etj.) Shef i Qendrës së Gruas Shef njësie në QSUNT Shef njësie në spitalin rajonal “Memorial” Fier	1	2%	0	90.300	
5	Shef reparti/klinike reanimacioni	1	2%	0	90.300	1100
6	Shef reparti/klinike psikiatrie	1	2%	0	90.300	5000

7	Shef i Laboratorit Klinik Biokimik Shef reparti kimioterapi Shef laboratorit Shef i Qendrës së Diagnozës Molekulare	1	2%	0	90.300	2200
8	Shef Reparti i Rrezatimit	1	2%	0	90.300	4600
9	Shef sektori mjekësor Shef farmacie	1	2%		82.460	
10	Përgjegjës i Sektorit të Laboratorëve/shef i Bankës së Gjakut/shef i Sektorit të Mbledhjes dhe i Përpunimit të Gjakut në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut	1	2%	0	82.460	2500
11	Mjek Stomatolog Biolog, kimist, fizikant në preparatorit. Mikrobiolog, parazitolog, virolog, mykolog Përgjegjës qendre DDD Përgjegjës njësie në QSUNT Specialist fizikulture (fizioterapi neurologji)	1	2%	0	79.800	
12	Mjek/biokimist/biolog në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut	1	2%	0	79.800	1600
13	Mjek infeksionist në QSUNT Mjek infeksionist në spitalin rajonal “Memorial” Fier	1	2%	0	79.800	8000
14	Mjek kirurg (specialitete kirurgjikale) Mjek onkolog Mjek fizioterapevt Mjek obsteter gjinekolog Mjek pneumoftiziatër	1	2%	0	79.800	1100
15	Mjek radilolog Toksikolog, alkolog, kimist, në laboratorin toksikologjik Kimist në laboratorin biokimik Fizikant në laboratorin biokimik Biolog në laboratorin biokimik	1	2%	0	79.800	1600
16	Mjek radiolog, në shërbimin infektiv në QSUNT dhe në shërbimin infektiv në spitalin rajonal “Memorial” Fier Mjek në kabinetin e ekografisë, në Shërbimin Infektiv në QSUNT dhe në kabinetin e ekografisë në spitalin rajonal “Memorial” Fier	1	2%	0	79.800	8000
17	Mjek kimioterapeut Mjek hematolog Mjek infeksionist Mjek në pranim urgjence Mjek në njësinë nozokomiale Mjek laboratorit Mjek histopatolog Mjek në shërbimin e gjakut	1	2%	0	79.800	2000
18	Mjek në Inspektoratin Sanitar Inspektor sanitar Farmacist	1	2%	0	79.800	2500
19	Farmacist në Laboratorin Toksikologjik Mjek në hemodinamikë	1	2%	0	79.800	2800
20	Mjek anatomopatolog Mjek anesteziat, reanimator Mjek në pavijonin e rrezatimit Specialist në qendrën e diagnozës molekulare Mjek pediatër neonatolog Fizikant kobalti	1	2%	0	79.800	3700

21	Mjek, psikolog, punonjës social që punojnë në psikiatri	1	2%	0	79.800	5000
----	---	---	----	---	--------	------

Lidhja nr. 2 (kreu 2.1)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin teknik të shkencave mjekësore, në strukturat shëndetësore universitare e në spitalet e nivelit terciar dhe personelin teknik të shkencave mjekësore, civilë, në njësinë mjekësore ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës

EMËRTIMI		PAGA MUJORE				
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Kryeinfermier Shërbimi Psikiatrik		2%	0	56.000	6000
2	Kryeinfermier shërbimi në shërbimin infektiv në QSUNT Kryeinfermier shërbimi në shërbimin infektiv në spitalin rajonal “Memorial” Fier. Kryeinfermier/kryemami e përgjithshme		2%	0	56.000	8000
3	Kryelaborant në Shërbimin e Anatomisë Patologjike Kryeinfermier Shërbimi i Terapisë Intensive Kryeinfermier Shërbimi Onkologjik Kryelaborant Rrezatim Kobalti Kryelaborant në Histopatologji Kryeinfermiere të Repartit të Rrezatimit		2%	0	56.000	3400
4	Kryeinfermier reparti/njësi psikiatrike		2%	0	56.000	5000
5	Kryeinfermier Reparti në Shërbimin Infektiv në QSUNT Kryeinfermier reparti në shërbimin infektiv në spitalin rajonal “Memorial” Fier		2%	0	56.000	8000
6	Kryeinfermier shërbimi Neurokirurgji Kryeinfermier/kryemami reparti i Terapisë Intensive/Stroke dhe Post stroke Kryeinfermier në Hemodinamikë		2%	0	56.000	2600
7	Kryeinfermier kimioterapi Kryelaborant klinik biokimik Kryeinfermier në urgjencën e Sëmundjeve të Brendshme Kryeinfermier/mami salle Kryeinfermier/mami e dhomës së zgjimit Infermier në hemodinamikë Kryelaborant imunolog, bakteriolog		2%	0	56.000	1800
8	Kryeinfermier shërbimi (kirurgji, neurologji, djegie plastike, kardiokirurgji, maksilofacial, infektiv, pediatrik infektive, obsetrik) Kryeinfermier/kryemami në Repartin e Kirurgjisë Kryemami turni në kirurgji/në obsetrikë Kryeinfermier Reparti Infektiv Kryeinfermier reparti (fizioterapi, urologji, urgjencës së neurologjisë, neurokirurgji, onkologji) Kryeinfermier/kryemami salle operacioni		2%	0	56.000	1100
9	Kryeinfermier shërbimi Kryelaborant shërbimi		2%	0	56.000	

	Kryemami shërbimi Kryeinfermier/kryelaborant në QKTGJ					
10	Infermier/laborant në psikiatri	2%	0	53.200	5000	
11	Laborant histopatolog	2%	0	53.200	3400	
12	Infermier/mami reanimacioni, neonatologji Infermier në dhomën e zgjimit	2%	0	53.200	2650	
13	Infermier në kimioterapi	2%	0	53.200	1800	
14	Kryelaborant imazherie	2%	0	53.200	1500	
15	Specialist i Sektorit të Kujdesit Infermieror	2%	0	53.200	1100	
16	Kryeinfermier në repartin e alergologjisë	2%	0	53.200		
17	Laborant radiolog në onkologji	2%	0	47.000	3700	
18	Laborant rrezatim kobalti	2%	0	47.000	3400	
19	Laborant në mjekësinë bërthamore	2%	0	47.000	2650	
20	Infermier në Njësinë e Inspektoratit Sanitar dhe Infeksioneve Nazokomiale Infermier/mami në sallën e operacionit	2%	0	47.000	2100	
21	Kryeinfermier reparti pranim urgjence Laborant klinik biokimik Infermier në punktin e gjakut Infermier në hematologji Infermier në onkologji Infermiere endoskopie Infermier/laborant bakterilog, imunolog	2%	0	47.000	1800	
22	Infermier reparti radiologjik/angio CT Teknik imazherie dhe angio CT Laborant radiolog Kryeinfermier (pranim urgjence, djegie plastike, kirurgji) Kryemami në qendrën e gruas	2%	0	47.000	1500	
23	Infermier/mami (kirurgji, maksilofaciale, neurokirurgji, kardiokirurgji, djegie plastike, obsetrike, gjinekologji/patologji barre/neonatologji) Infermier salle Infermier/laborant në QKTGJ	2%	0	47.000	1100	
24	Kryeinfermier neonatologji Kryemami pranimi Kryeinfermier në kabinetin e dializës Kryemami/kryeinfermier reparti/klinik/turni Kryeinfermier konsultash në sëmundjet e brendshme Kryelaborant bakteriolog, imunolog, ortopedi stomatologjike)	2%	0	47.000		
25	Infermier pavijoni rrezatimi	2%	0	45.000	3310	
26	Infermier në shërbimin infektiv në QSUNT Infermier në shërbimin infektiv në spitalin rajonat “Memorial” Fier	2%	0	45.000	8000	
27	Infermier pranim urgjence (njësia e koordinimit të urgjencës)	2%	0	45.000	1800	
28	Infermier në hemodializë	2%	0	45.000	1500	
29	Infermier fizioterapi	2%	0	45.000	1100	
30	Laborant (ezhe, ortopedi, stomatologji) Infermier Mami Logopedi Infermier çerdheje për personelin Kujdestar Prozektar	2%	0	45.000		
31	Kujdestar në psikiatri	2%	0	39.550	5000	

**Shpërblimi për punonjësit e personelit të caktuar nga pala turke në spitalin rajonal “Memorial”
Fier**

	Emërtimi i pozicionit	Masa mujore e shpërblimit, në lek
1	Nëndrejtor (teknik)	266,000
2	Nëndrejtor (administrativ)	161,000
6	Shef shërbimi	285,000
4	Mjeke te specialiteteve te ndryshme	305,000
5	Farmacist	142,000
6	Kryeinfermier i përgjithshëm	227,000
7	Infermier	181,000
8	Përgjegjës sektori	104,000
9	Specialist	120,000
10	Teknik biomedikal	102,000